



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELFGOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA
QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIALNE ZASTITE

Në përputhje me nenin 1 të Rregullores nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë;

Duke pasur parasysh dispozitat e Rregullores nr. 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë;

Me qëllim të evitimit dhe eliminimit të keqpërdorimeve të familjeve lidhur me shfrytëzimin e pensioneve bazë, pas vdekjes së shfrytëzuesit të pensionit;

Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 08/2007
PËR
NDALËSAT E PAGESAVE TË PENSIONIT THEMELOR NË RASTET KUR
PENSIONISTËT VDESIN

Neni 1

Administrimi i Pensioneve Themelore

1.1 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është përgjegjëse për administrimin e pensioneve themelore. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale ka autorizuar Departamentin e Administratës Pensionale të Kosovës (DAPK) për administrimin e përditshëm të pensioneve.

1.2 Pensioni themelor iu paguhet vetëm personave që i plotësojnë kushtet dhe kriteret sipas legjislacionit të aplikueshëm dhe të cilët janë gjallë.

1.3 DAPK-ja ka obligim ligjor që të sigurohet se pensionet nuk iu paguhen personave që e humbin të drejtën në pagesë të tillë. Kjo do të thotë se çdo nëpunës i DAPK-së duhet ta mbrojë me kujdes të madh ligjshmërinë e pensioneve themelore. Nëpunësit e DAPK-së duhet të përpiqen që ti gjejnë rastet e vdekjes së pensionistëve. Kjo do të thotë se çdo Zyrë Rajonale e DAPK-së në mënyrë aktive duhet të mbledhë detaje të pensionistëve të cilët kanë vdekur dhe këto të dhëna ti dërgojë në sektorin e kontrollit të DAPK-së, në mënyrë që të mos iu bëhen pagesat.

Neni 2 Vdekja e pensionistëve

- 2.1 Pensioni themelor nuk iu paguhet personave që kanë vdekur.
- 2.2 Kur pensionisti vdes, pensioni themelor duhet të mos i paguhet prej fillimit të muajit (p. sh. nëse pensionisti vdes në muajin gusht, atëherë pensioni nuk paguhet në muajin shtator e më tej).
- 2.3 Në disa raste xhirollogaritë bankare mund të kenë gjithashtu emra të personave të tjerë (p. sh. të anëtarëve të familjes). Megjithatë, pas vdekjes së pensionistit nuk është e lejueshme për asnjë person që të marrë pagesën e pensionit themelor.
- 2.4 Nëse një person tërheq paratë pas vdekjes së pensionistit, kjo do të konsiderohet mashtrim dhe personi duhet ta kthejë shumën e marrë. Kundër personit të tillë do të ndërmerren masa ligjore.

Neni 3 Njoftimi i rastit të vdekjes

- 3.1 DAPK-ja ka për obligim të kërkojë informata për personat të cilët kanë qenë shfrytëzues të pensionit themelor dhe ndërkohë kanë vdekur. Kjo do të thotë se DAPK-ja Qendrore dhe Zyrat Rajonale do të mbajnë kontakte me komunat dhe organizatat tjera publike (spitalet, klinikat) në mënyrë që informatat të procesohen në DAPK. DAPK-ja do të mbajë kontakte të ngushta me Zyrën Qendrore të Regjistrimit për ti marrë të gjitha hollësitë e vdekjes së pensionistëve në mënyrë që të reagojë menjëherë.
- 3.2 Të gjitha Zyrat Rajonale të DAPK-së duhet të mbledhin informata për vdekjet (e vërtetuara dhe të pavërtetuara) dhe duhet t'i dërgojnë çdo javë në sektorin e kontrollit të DAPK-së në Prishtinë.
- 3.3 Formularët që duhet të shfrytëzohen për këtë qëllim janë të bashkangjitur në shtojcën A (D -Forma 1 dhe D - Forma 2).

Neni 4 Vërtetimi i vdekjes së pensionistit për të konfirmuar vdekjen e tij

4.1 Zyra Rajonale e DAPK-së do të kërkojë informata nga burimet që vijojnë:

- Certifikata e vdekjes,
- Njoftimi i vdekjes në gazeta,
- Njoftimi i vdekjes në vende publike (p. sh. në mure, drunj, etj.),
- Njoftimi i vdekjes në Zyrat Rajonale të DAPK-së nga anëtarët e familjes së pensionistit,
- Njoftimi për vdekjet në Zyrat Rajonale të DAPK-së nga ana e policëve, mjekëve, spitalit, autoriteteve komunale nga çfarëdo organ tjetër publik,
- Informatat për rastet e vdekjeve që publikohen në gazeta.

Nëse burimet e përmendura përmbajnë datën (madje vitin) e vdekjes së pensionistit, atëherë Zyrat Rajonale të DAPK-së do ta raportojnë Zyrën Qendrore të DAPK-së si njoftim i vërtetuar i

vdekjes.

4.2 Zyra Rajonale e DAPK-së do ta njoftojë Zyrën Qendrore të DAPK-së, përmes Formularit - D 1 në shtojcën A.

4.3. Zyra Qendrore e DAPK-së do ta kontrollojë informatën me shënimet e TI-së (teknologjisë informative), dhe nëse ka nevojë edhe me dosjen e kërkesave. Nëse të dhënat përputhen (emri, adresa, etj.), atëherë Zyra Qendrore e DAPK-së do ti ndalojë pagesat.

Zyra Qendrore e DAPK-së do t'ju dërgojë të gjitha Zyrave Rajonale (çdo muaj) një listë të pagesave të ndaluara përgjithmonë (shih Formularin - D 4 Shtojca A). Kjo listë do të përfshijë emrin e pensionistit, adresën, letërnjoftimin e UNMIK-ut dhe datën e ndalesës së pensionit.

Neni 5

Vdekja e pavërtetuar pensionistit

5.1 Nëse informata e marrë nga burimet e shënuara më lartë në paragrafin 4.1 nuk përfshin datën e vdekjes, atëherë njoftimi do të konsiderohet i pavërtetuar. Më poshtë janë dhënë shembujt e njoftimeve të pavërtetuara:

- Njoftimi i vdekjes në gazeta – kjo nuk jep detaje të mjaftueshme për të qenë të sigurt se pensionisti ka vdekur (p. sh. nuk tregohet viti i lindjes),
- Njoftimi i vdekjes në vende publike (p. sh. në mure apo drunj) kjo nuk jep detaje të mjaftueshme për të qenë të sigurt se pensionisti ka vdekur (p. sh. nuk tregohet viti i lindjes),
- Njoftimi jo zyrtar i vdekjes në Zyrën Rajonale të DAPK-së (përveç kur Zyra Rajonale e DAPK-së është e sigurt se pensionisti ka vdekur),
- Mos përgjigja në hetimet ose inspektimet e inspektorëve të Zyrave Rajonale të DAPK-së, Informata të tjera që e shtyjnë Zyrën Rajonale të DAPK-së të dyshoj se pensionisti ka vdekur.

5.2 Zyra Rajonale e DAPK-së do ta njoftojë Zyrën Qendrore të DAPK-së përmes Formularit D 2 në shtojcën A.

5.3 Zyra Qendrore e DAPK-së do të:

- Kontrollojë të dhënat me shënimet e TI-së dhe dosjen e kërkesave,
- Suspendojë pensionin themelor dhe
- Mundësisht të dërgojë njoftim në adresën e pensionistit, ose në pamundësi të dërgimit të njoftimit në adresë të pensionistit, mjafton si njoftim mos bartja e –transferi i shumës së pensionit të ndaluar në llogarinë e tij bankare . Nga momenti i ndaljes së transferit në xhirollogarinë bankare, fillon të rrjedh afati kohor në përputhje me të dhënat për suspendim të cilat përcillen nga sektori i teknologjisë informative.

5.4 Në njoftimin që e dërgon DAPK-ja do të kërkohet verifikimi i informatës që ka shkaktuar suspendimin e pagesës.

5.5 Zyra Qendrore e DAPK-së çdo muaj do ti dërgojë secilës Zyrë Rajonale një listë të pagesave të suspenduara (shih Formularin – D 5 në shtojcën A). Kjo listë do të përfshijë emrin e pensionistit, adresën, letërnjoftimin e UNMIK-ut dhe datën e pagesës së suspenduar.

5.6 Nëse pensionisti përgjigjet në letrën e DAPK-së, atëherë prej atij kërkohet që të shkojë në Zyrën Rajonale të DAPK-së, të ketë letërnjoftimin e UNMIK-ut në mënyrë që të mund të identifikohet pozitivisht. Paga nuk do të fillojë derisa pensionisti të mos ketë shkuar në Zyrën Rajonale të DAPK-së apo deri sa nëpunësi i Zyres Rajonale të DAPK-së të mos i identifikojë

pozitivisht të dhënat e letërnjoftimit të UNMIK-ut. Zyra Rajonale e DAPK-së do ta shfrytëzojë Formularin D 3 (i bashkangjitur në shtojcën A) atëherë kur ta identifikojë pozitivisht pensionistin me të drejtën për pagesë të pensionit.

5.7 Nëse Zyra Rajonale e DAPK-së bën hetime dhe konfirmon se pensionisti ka vdekur, atëherë ajo duhet ta njoftojë Zyrën Qendrore të DAPK-së për këtë, përmes Formularit - D 1 (i bashkangjitur në shtojcën A).

Neni 6 Lajmërimi i pensionistëve

6.1 Shfrytëzuesit e pensionit themelor janë të obliguar që të lajmërohen personalisht ose përmes personit të autorizuar dy herë në vit (një herë në gjashtë muaj) në Zyrat Rajonale të Departamentit të Administratës Pensionale të MPMS-së.

6.2 Me rastin e lajmërimit, shfrytëzuesit e pensionit themelor janë të obliguar që të nënshkruajnë personalisht regjistrin përkatës për lajmërim të pensionistëve, së bashku me zyrtarin e Zyrës Rajonale të DAPK-së të autorizuar për mbajtjen dhe udhëheqjen e evidencës së lajmërimit të pensionistëve.

Pensionisti me këtë rast duhet të sjellë me vete këto dokumente identifikuese:

- Letërnjoftimin e UNMIK-ut;
- Fletë autorizimin nëse pensionisti e autorizon përfaqësuesin e tij,
- Vërtetimin se shfrytëzuesi i pensionit është gjallë nga organi kompetent komunal (kur shfrytëzuesi i pensionit e autorizon përfaqësuesin e tij për marrjen e pensionit).

6.3 Nëse shfrytëzuesi i pensionit themelor nuk lajmërohet në Zyrën Rajonale të DAPK-së (siç është përcaktuar në paragrafin 6.1. të këtij neni), ai do të suspendohet në shfrytëzimin e këtij pensioni nga DAPK-ja.

6.4 Për vazhdimin e sërishëm të pagesës së pensionit themelor, pensionisti duhet të drejtohet me kërkesë Zyrës përkatëse të DAPK-së në përputhje me dispozitat e Rregullores 2001/35 mbi Pensionet në Kosovë dhe rregullat e përcaktuara nga DAPK-ja e MPMS-së.

6.5. Shfrytëzuesit të pensionit të suspenduar, do ti njihet e drejta në vazhdimin e sërishëm të pagesës së pensionit themelor :

1. nëse pensionisti në afat prej 6 muaj nga data e suspendimit, lajmërohet në Zyrën përkatëse të DAPK-së, do ti bëhet pagesa e pensioneve të papaguara.
2. nëse pensionisti nuk lajmërohet në afat në prej 6 muajshe nga dita e suspendimit atëherë kërkesa e tij do të merret si riaplikim.

Neni 7 Llogaritë bankare

7.1 Pensioni themelor paguhet vetëm përmes llogarive bankare.

7.2 Nga ana ligjore, pensioni themelor nuk i paguhet pensionistit të vdekur.

7.3 Në rastet kur një pensionist vdes dhe pagesat janë bërë pas vdekjes, atëherë Zyra Qendrore e DAPK-së do të kërkojë që banka ti kthejë pagesat që i janë dhënë familjes së pensionistit prej asaj date kur ka vdekur shfrytëzuesi i pensionit themelor.

7.4 Në rastet kur zyrtarët e bankës deklarojnë se kanë paguar pensionin themelor edhe pas vdekjes së pensionistit, atëherë DAPK-ja do të kërkojë nga banka që të tregoj se kujt ia ka paguar pensionin (p. sh. personit tjetër në llogarinë e tij bankare). Atëherë DAPK-ja do të kërkojë që personi që i ka marrë paratë ti kthejë ato.

7.5 Departamenti i Administratës Pensionale dhe Zyrat Rajonale të DAPK-së do të kontaktojnë

çdo muaj me bankat dhe do të kërkojnë informata për pensionistët për të cilët e dinë se kanë vdekur ose për të cilët kanë kërkuar që të hiqen nga llogaria bankare.

Neni 8

Shënimet e personave që kanë vdekur

8.1 DAPK-ja do të mbajë shënim për vdekjen e çdo pensionisti për të cilin është njoftuar.

8.2 Secila Zyra Rajonale e DAPK-së do të mbajë shënime për personat e tillë në rajonin e vet.

8.3 DAPK-ja do të mbajë shënime për secilin person të cilit i dërgon letër, me të cilën kërkon informatë rreth vdekjes së pensionistit.

Neni 9

Përgjegjësia për raportim

9.1 Është detyrë e zyrtarëve të Zyrave Rajonale të DAPK-së që të sigurohen se pensioni themelor të mos iu paguhet personave që kanë vdekur. Nëse nëpunësi i Zyrës Rajonale të DAPK-së dështon në raportimin e informatës të cilën ai/ajo e di për vdekjen e pensionistit, atëherë kjo do të trajtohet si shkelje serioze disiplinore që mund të rezultojë me inicimin e procedurës disiplinore ndaj nëpunësit i cili nuk ka informuar për vdekjen e pensionistit.

Neni 10

Dështimi në korrespondencë

10.1 Kur DAPK-ja merr vendim për të dhënë ose për të suspenduar pagesën, ajo i dërgon njoftim me shkrim shfrytëzuesit të pensionit.

10.2 Kur letra kthehet në DAPK, ky është treguesi i parë se pagesa duhet të shqyrtohet për t'u siguruar që shfrytëzuesi i pensionit është gjallë dhe se është duke jetuar në adresën ku i bëhet pagesa.

10.3 Çdo letër që kthehet duhet të përcillet nga DAPK-ja.

10.4 Zyra Qendrore e DAPK-së duhet ti dërgojë këto letra në secilën Zyra Rajonale të DAPK-së dhe të kërkojë të konfirmohet nëse pensionisti është ende gjallë.

10.5 Nëse shfrytëzuesi i pensionit është ende gjallë, atëherë Zyra Rajonale e DAPK-së duhet ta informojë DAPK-në me të dhënat nëse adresa e pensionistit është e saktë.

10.6 Nëse shfrytëzuesi i pensionit ka vdekur, atëherë Zyra Rajonale e DAPK-së, duhet ta informojë Zyrën Qendrore të DAPK-së përmes Formularit D1.

Neni 11
Menaxhimi i kontrollit

11.1 Sektori i kontrollit të Zyrës Qendrore të DAPK-së do të mbikëqyrë dhe kontrollojë secilën Zyrrë Rajonale të DAPK-së duke bërë:

- Inspektimet,
- Identifikimin e numrit të pensioneve të ndaluara për shkak të vdekjes së pensionistëve,
- Kursimet nga kostoja e pensioneve.

11.2 Zyra Qendrore e DAPK-së do t'ju mundësojë (sigurojë) transportin zyrtarëve, për ti bërë këto kontrollime.

Neni 12
Raportet

12.1 Udhëheqësi i Divizionit të Skemave Pensionale të DAPK-së do të përgatisë raport javor që duhet të përmbajë informata për secilin rajon, me të cilin tregohet numri i pagesave të:

- a) ndaluara përgjithmonë,
- b) suspenduara për shkak të konfirmimit jo të plotë të vdekjes së pensionistit.

12.2 Raporti duhet të përmbajë të dhëna për secilin rajon që mbulon Zyrra Rajonale dhe duhet ti dërgohet drejtorit të Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës dhe udhëheqësit të Divizionit të Pagesave të DAPK-së.

Neni 13
Hyrja në fuqi

13.1 Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, do të shfuqizohen:

- a) Udhëzimi Administrativ nr. 2/2003 dhe
- b) Udhëzimi Administrativ nr. 7/2006.

13.2 Ky Udhëzim Administrativ, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së.

Ministri i MPMS-së

Ibrahim Selmanaj

Datë:21.09.2007

Prishtinë